

VENDIM
I
Asamblesë së Ortakëve

Sot, më datë 17.12.2018, në selinë e Shoqërisë Tregtare "GRASSO COIN" sh.p.k., në adresën Bulevardi Bajram Curri, Pallati NCE/298, Kati nr.4, Ap. nr.16, 1004 Tiranë u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të kësaj shoqërie, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon:

1. Prishjen e Shoqërisë.
2. Caktimin e Likuiduesit.
3. Të ndryshme

Në Asamble janë të pranishëm ortaket Damiano Giuseppe Grasso, Fato Dani dhe Salvatore Grasso, me cilësinë e ortakeve themelues të shoqërisë;

Ortaket e shoqërisë pasi konstatuan rregullshmërinë e thirrjes shpallen të hapur mbledhjen dhe procedojne me shqyrtimin e rendit të ditës.

Ortaket e shoqërisë kane propozuar këto ndryshime në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k. :

- Damiano Giuseppe Grasso, Fato Dani dhe Salvatore Grasso në cilësinë e ortakeve të shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k. vendosin prishjen e Shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k.
- Damiano Giuseppe Grasso, Fato Dani dhe Salvatore Grasso në cilësinë e ortakeve të shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k. vendosin të caktojë si likuidatore të shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k. Z. Fatos Dani.

Asambleja e Ortakëve, në mbështetje me Statutin e Shoqërisë dhe ligjin Nr. 9901 dt 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe ligjin Nr. 8438 dt 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat"

VENDOSI:

1. Të miratojë prishjen e Shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k
2. Të miratojë emërimin e Z.Fatos Dani si likuidatore të Shoqërisë "GRASSO COIN" sh.p.k
3. Të ngarkojë administratorin Fatos Dani per depozitimin e këtij vendimi në QKB.

ORTAKET E SHOQËRISË
"GRASSO COIN" sh.p.k

Damiano Giuseppe Grasso

Fato Dani

Salvatore Grasso

